TENET SH.A

Raporti i audituesve të pavarur dhe pasqyra e ndryshimeve ne kapital

për periudhën nga

31 dhjetor 2020 deri më 15 qershor 2021

Nexia AL

Str. Ismail Qemali, No.29,
3-rd floor, Apartment 6,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për aksionerët dhe drejtuesit e Shoqërisë
TENET SH.A

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin aksionar të TENET SH.A ("Shoqëria") për periudhën nga 31 dhjetor 2020 deri më 15 qershor 2021 ("pasqyra").

Sipas opinionit tonë informacioni financiar në pasqyrën kapitalit te Shoqërisë për periudhen nga 31 dhjetor 2020 deri më 15 qershor 2021 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me parimet kontabël të paraqitura në shënimin 2 të pasqyrës.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit tonë ku jepen përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrës. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrës në Shqipëri, dhe kemi përmbushur kërkesat e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i Çështjes – Baza Kontabël dhe Kufizimet në Përdorim

Ne tërheqim vëmendje tek shënimi 2 i pasqyrës, i cili përshkruan bazën kontabël. Pasqyra është përgatitur për qëllime të certifikimit të rritjes së kapitalit aksionar dhe nuk është pjesë e kërkuar e pasqyrave financiare të përgatitura për qëllime ligjore. Si rezultat pasqyra mund të mos jetë e përshtatshme për tu përdorur për qëllime të tjera. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisje në lidhje me Pasqyrën

Drejtim është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrës në përputhje me parimet kontabël të përfshira në shënimin 2 të pasqyrës, dhe për kontrollin e brendshëm që Drejtimi përcakton se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrës pa anomali materiale, që mund të jenë pasojë e gabimeve apo mashtrimit.

Në përgatitjen e pasqyrës, Drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë, duke paraqitur sipas rastit çështje lidhur me parimin e vijimësisë si dhe suke përdorur parimin e vijimësisë perveç rastit kur derjtimi ka për qëllim ose të likuidojë Shoqërinë ose të ndalojë veprimtarinë, ose nuk ka alternativë reale përvçse për të vepruar në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me Qeverisje janë përgjegjës për të mbikqyrur procesin e raportimit financiar të Shoqërisë.

Nexia AL

Str. Ismail Qemali, No.29,
3-rd floor, Apartment 6,
Tirana, Albania
T: +355 4 223 2726
www.nexia.al

Përgjegjësia e Audituesve për Auditimin e Pasqyrës

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyra në tërësi nuk ka anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojm një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konisderohen si materiale nëse,individualisht pse të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojme rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i larte se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qellimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së nje opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vleresojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Arrijmë në përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, perveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit.

Nexia AL

Auditues Ligjor
Orjana Kalaja

Tiranë, Shqipëri 23 qershor 2021

Nexia AL
K91724010Q

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për periudhën nga 31 dhjetor 2020 deri me 15 qershor 2021

a. Rritja nga fitimet e pashpërndara me 31 dhjetor 2020 ne kapitalin aksionar:

Bazuar ne Vendimin e Aksionareve te dates 15 qershor 2021, Tenet sh.a ("Shoqëria") rriti kapitalin e paguar nga fitimet e pashpërndara me 31 dhjetor 2020. Kapitali aksioner me 31 dhjetor 2020 dhe 15 qershor 2021 eshte si vijon:

	Kapitali Aksionar ne 31 dhjetor 2020	Zmadhim nga fitimet e pashpërndara me 31 dhjetor 2020 me vendim te datës 15 qershor 2021	Kapitali Aksionar ne 15 qershor 2021
	LEK	LEK	LEK
Kapitali Aksioner	155,000,000	51,448,000	206,448,000

b. Rritja nga fitimi i vitit 31 dhjetor 2020 ne rezervën ligjore:

Bazuar ne Vendimin e Aksionareve te dates 15 qershor 2021, Tenet sh.a ("Shoqëria") rriti rezervën ligjore nga fitimi i vitit qe mbyllet me 31 dhjetor 2020 si vijon:

	Rezerva ligjore me 31 dhjetor 2020	Rritja e rezervës ligjore nga fitimi i vitit 31 dhjetor 2020	Rezerva ligjore me 15 qershor 2021
	LEK	LEK	LEK
Rezerva ligjore	1,220,953	2,708,098	3,929,051

Struktura e pronësisë me 31 dhjetor 2020 dhe 15 qershor 2021 eshte si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		15 qershor 2021	
	Totali ne Lek	%	Totali ne Lek	%
Kastrati Group SHA	77,500,000	50	103,224,000	50
VITRIOL SHA	77,500,000	50	103,224,000	50
Total	**155,000,000**	**100**	**206,448,000**	**100**

Shënim 1: Rritja e Kapitalit
Shuma e zmadhuar nga fitimet e pashperndara me 15 qershor 2021 prej 51,448,000 LEK është matur në perputhje me politikën kontabël të përcaktuar ne Shenimin 2 me poshte.

Shenimi 2: Kapitali
Kapitali aksionar konsiston ne mjetet monetare te kontribuara nga themeluesit e shoqërisë dhe nga fitimet e pashpërndara te transferuara sipas vendimit te aksionareve. Kapitali aksionar paraqitet me vleren ne Lek te konvertuar me kursin e kembimit te dates se transaksionit, dhe me shumen e fitimeve te pashpërndara te transferuara ne kapital sipas vendimit te aksionareve. Kapitali aksionar i shoqerise njihet me vlere nominale.

Shenimi 3: Politikat Kontabel
Bazuar ne politikat kontabël te shpjeguara ne shënimet shpjeguese te pasqyrave financiare te përgatitura ne përputhje me SNRF per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2020, kapitali matet sipas shënimeve sqaruese ne politiken kontabël 3.

Ky informacion financiar me qellim te vecante nuk eshte nje pakete e plote e pasqyrave financiare ne përputhje me SNRF.